



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:103932

Datë: 04.08.2023

Numri i dokumentit: 04557113

Rev.nr.258/23

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: K. K.1, K. K.2, N. K., F. N.-K. të gjithë nga P., të cilët i përfaqëson Mustafë Kastrati, avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurit: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në P., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar B. M., sipas autorizimit, për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.6089/2020, të datës 07.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i të paditurit: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në P., i paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.6089/2020, të datës 07.04.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.765/2018, të datës 28.09.2020, është vendosur: Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K. K.1 nga P., e parashtruar kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës për kompensim dëmi. I. Detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në P., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, për 88 ditë të qëndrimit të tij në paraburgim, t'ia paguaj shumën prej 1,246.96 €, në emër të fitimit të humbur për 88 ditë shumën prej 2,537.92 €, në emër të fitimit të humbur, për periudhën pas paraburgimit shumën prej 338.38 €, në emër të dëmit për dhembjet e përjetuara shpirtërore për shkak të akuzimit të pabazë shumën prej 12,000 €, e në shumë totale prej 16,123,26 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e përpilimit të

ekspertizës mjekësore më datë 12.02.2019, e gjer në pagesën definitive. II. Refuzohet kërkesë padia e paditësit K. K.1 nga P., përtej shumave të aprovuara si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi si jo e bazuar. III. Refuzohet kërkesëpadia e paditësve K. (E.) K.2, N. K., F. N.-K., të gjithë nga P., kundër të paditurës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për kompensimin e dëmit si jo e bazuar. IV. Obligohet e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në P., që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 364.20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. V. Refuzohet kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar si në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktgjykimi sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.6089/2020, të datës 07.04.2023, është vendosur: Aprovohet ankesa e të paditurit Këshillit Gjyqësor i Kosovës, e paraqitur nga përfaqësuesi B. M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.765/2018, i datës 28.09.2020, ndryshohet dhe gjykohet: Detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial, për mbajtje (në paraburgim në kohëzgjatje prej 88 ditësh), pa bazë ligjore, t'ia paguaj paditësit K. K.1 shumën prej 4.400 €. Përtej shumës së gjykuar si në paragrafin I, në shumën prej 7.600 €, si dhe kamatëvonesa në këtë shumë, kërkesëpadia e paditësit kundër të paditurit refuzohet si e pathemeltë. Refuzohet si e pathemeltë, ankesa e të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ndërsa aktgjykimi ankimor për shumën e gjykuar paditësit, në emër të shpërblimit të dëmit material: për fitim të humbur, për shkak të mbylljes së lokalit afarist "K.", në kohëzgjatje prej 88 ditësh, në shumën prej 2,537.92 €, për qëndrim në paraburgim të paditësit në kohëzgjatje prej 88 ditësh, shumën prej 1,246.96 €, dhe për periudhën e rehabilitimit të veprimtarisë së biznesit në shumën 338.38 €, e në shumën e përgjithshme prej 4,123.26 €, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion i padituri, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vetëm sa i përket pikës I, të dispozitivit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe çështjen t'ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Me përgjigje në revizion, paditësi ka kërkuar që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pathemeltë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, më datë 15.02.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqit padi, kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në parashtrësën për precizimin e padisë, të dorëzuar më datë 11.12.2019.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.765/2018, të datës 28.09.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: nga ekspertiza dhe plotësim ekspertiza e ekspertit financiar G. G., u vërtetua se dëmi material i shkaktuar paditësit K. K.1, për periudhën e cila nuk është kontestuese mes palëve ndergjyqëse, prej datës 04.11.2012 gjer më datë 01.02.2013, për qëndrimin në paraburgim për 88 ditë, do ti takonte shpërblimi i dëmit material në bruto në lartësi 1,246.96 €, në emër të fitimi të humbur dhe atë për kohën e qëndrimit të mbyllur për 88 ditë, paditësit K. K.1, do ti takonte vlera prej 2,537,92 €, ndërsa fitimi i humbur pas periudhës së paraburgimit paditësit do ti takonte shuma prej 338.33 €, e në bazë të së cilës ekspertizë dhe plotësim ekspertizë, gjykata vendosi për lartësinë e dëmit material si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Ka theksuar se gjykata vendosi për dëmin jomaterial në emër të dhimbjeve shpirtërore, për shkak të akuzimit të pabazë për paditësin K. K.1, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që vendimin e mbështeti në ekspertizën e ekspertit mjekësorë M. B. neuropsikiatër dhe S. K. psikolog, si dhe në vlerësimin e gjykatës për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, në bazë të kësaj gjykata vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi sa i përket dëmit jomaterial.

Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve K. (E.) K.2, N. K., F. N.-K., si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në nenin 525.1. të Kodit të Procedurës Penale, ku theksohet se: të drejtë në kompensim dëmi, për dënim të paarsyeshëm, ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, nga kjo rrjedh se kërkesa e paditësve K. N. dhe F. nuk është e bazuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 173 dhe 183 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Për kamatën ka vendosur në kuptim të nenit 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj CA.nr.6089/2020, të datës 07.04.2023, ka vendosur që të aprovojë ankesën e të paditurit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit ka konstatuar se shuma e gjykuar në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, të cilën është obliguar i padituri t'ia paguaj palës paditëse, në shumën 12.000 €, rezulton nga ajo se gjykata e shkallës së parë, për çdo ditë "paraburgimi", në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial, i ka caktuar shumën prej 136 €, e që ishte në kundërshtim me praktikën gjyqësore, standardin ekonomik dhe shoqëror në Kosovë, e që ka rezultuar me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/19 Qershor 2012, i cili konsiderohet se ka hy në fuqi nga data 20 dhjetor 2012 me tej LMD). Andaj, kolegji vlerëson se si pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, aktgjykimi ankimor sipas bazës ligjore të nenit 201 të LPK, duhej ndryshuar, duke gjykuar shumën si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të

ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

I padituri në revizionin e paraqitur nuk i është referuar si bazë për parashtrimin e revizionit shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së, me ç’ rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësve gjen mbështetje në nenit 154, 158 dhe nenit 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, me nenin 158 të LMD-së, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”.

Baza juridike nuk ka qenë kontestuese sipas revizionit, prandaj Gjykata Supreme në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materialo - juridike është kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave për të cilën palët mund të disponojnë lirishtë në këtë rast.

Gjykata Supreme e Kosovës e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë, për zbatimin e drejtë të drejtës materiale, në përputhje me gjendjen faktike të provuar në këtë rast edhe për kundër faktit se është dashtë të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 1978, dhe jo të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/19 Qershor 2012, i cili ka hy në fuqi nga data 20 dhjetor 2012 me tej LMD) Ligji Nr.04/L-077, mirëpo duke pas parasysh se dispozitat e ligjit të vjetër nuk kanë dallime substanciale, me ligjin që kanë aplikuar gjykatat e instancave më të ulëta, gjykata konsideroj se vendimi është i drejt dhe i ligjshëm, për arsye se:

Në kuptim të dispozitave materiale - juridike të cilave u është referuar Gjykata Supreme e në përputhje me gjendjen faktike, drejt është zbatuar e drejta materiale. Në këtë rast nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qëndruar në paraburgim në kohëzgjatje prej 88 ditësh pa të drejtë. Gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe marrjen e provës me ekspertizë të psikiatrisë për të konstatuar dhimbjet shpirtërore të paditësit gjatë qëndrimit në paraburgim, por sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, një ekspertizë e tillë duhet të shikohet në kontekstin e rrethanave të caktuara që kanë ndikuar në shkaktimin e dhimbjeve shpirtërore - vuajtje psikike nga shkak se janë pikërisht rrethanat e caktuara të cilat gjykata duhet ti vlerësojë me rastin e caktimit të kompensimit për këtë kategori të dëmit qoftë edhe pa marrjen e provës me ekspertizë.

Me nenin 200 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e

dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Nga interpretimi i paragrafit 1 të nenit 200 të LMD-së, rezulton se për dhimbjet e pësuar shpirtërore do të gjykohet shpërblimi, por në çdo rast dhimbjet shpirtërore duhet të jenë pasojë e një rrethane që e shkakton dhimbjen siç mund të jetë shkelje e nderit, e lirisë, e vdekjes së të afërmit, etj. Pra nuk mund të gjykohet kompensimi për dhimbje shpirtërore -vuajtje psikike, pa qenë dhimbje shpirtërore - vuajtja psikike e ndërlidhur me një rrethanë që e shkakton dhimbjen. Në këtë kontekst Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se bazë për të gjykuar për dhimbjet shpirtërore-vuajtje psikike sikur të përfaqësonte një kategori të dëmit jomaterial është dispozita ligjore nga neni 200 i LMD-së. Në këtë rast në kontekstin e dispozitës së cituar nga paragrafi 1, i nenit 200 të LMD-së, paditësit i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore-vuajtjet psikike (vuajtjet psikike në literaturë përdoren si përjetim analog i dhimbjeve shpirtërore që i korrespondon dispozitës së cituar) për shkak të cenimit të autoritetit shkeljes, nderit, lirive dhe të drejtave të personalitetit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke i vlerësuar edhe rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 200 të LMD-së, vlerësoi se shuma e gjykuar si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit, të gjykatës së shkallës së dytë, në emër të kompensimit për dhimbjet shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirive dhe të drejtave të personalitetit është në proporcion me të mirën e shkelur dhe me qëllimin e kompensimit për dëmin jomaterial. Gjykata vlerësojë posaçërisht rrethanat se natyra e veprës për të cilën ishte akuzuar paditësi ishte e rëndë - kryerja e veprave shmangie nga tatimi dhe pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me vepër penale dhe rrjedhimisht dhimbjet shpirtërore për shkak të akuzës kanë qenë të shkallës së lartë ashtu siç edhe eksperti ka konstatuar me ekspertizë. Përveç dhimbjeve shpirtërore që ka shkaktuar natyra e veprës për të cilën është akuzuar paditësi në shkallën e dhimbjeve gjykata ka vlerësuar se ka ndikuar edhe kufizimi i lirisë në këtë rast si i paraburgosur për një periudhë relativisht të gjatë prej 88 ditësh dhe kur këto dy rrethana janë bashkuar sigurisht që tek paditësi kanë ndikuar në intensitetin e dhimbjeve. Megjithatë Gjykata Supreme e Kosovës, rithekson se kompensimi i dëmit jomaterial në vetvete ka një qëllim e që është satisfaksioni për të dëmtuarin. Në këtë kontekst kjo gjykatë vlerëson se shpërblimi i dëmit në këtë rast është caktuar në kuptimin që të jetë i drejtë dhe adekuat me vëllimin e dëmit që ka pësuar paditësi. Kjo nënkupton se lartësia e kompensimit jepet si satisfaksion dhe motivohet nga qëllimi që t'i mundësojë paditësit satisfaksion - kënaqje të caktuar për vlerën e dëmit jomaterial. Gjykata kur ka vendosur për vlerën e kompensimit ka marr parasysh rrethanat që kanë ndikuar në shkallën e të drejtave të cenuar si pasojë e procedurës penale siç janë kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim, natyra e veprës për të cilën është akuzuar, moshën e të dëmtuarit, profesionin e tij dhe rrethanat familjare e shoqërore.

Gjykata Supreme, e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë me lartësinë e shumave të gjykuara palës paditëse në emër të dëmit jomaterial të gjykuar nga gjykata e shkallës dytë sipas aktgjykimit të

cekur, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet sipas revizionit nga pala e paditur, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së dytë në përputhje me gjendjen faktike edhe pse ka aplikuar ligjin Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/19 Qershor 2012, i cili konsiderohet se ka hy në fuqi nga data 20 dhjetor 2012 me tej LMD) Ligji Nr.04/L-077, e njëjta ka vendosur drejt sepse edhe dispozitat e ligjit të vjetër e rregullojnë çështjen në të njëjtin mënyrë.

Vendimi sa i përket kamatës së gjykuar nga gjykata e shkallës së dytë është i drejtë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, dhe Mendimin Juridik për Kamatën, të Gjykatës Suprem të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.258/23, datë 31.07.2023.

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi